



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

ADGJTHFR.5/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur në çështjen disiplinore, sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga pala ankuese R.B.K. J.S.C., Rr. "...", nr. ..., Prishtinë (në cilësinë e kreditorit), me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj F.A., në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 3 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 25 prill 2023, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, F.A., e paraqitur nga pala ankuese R.B.K. J.S.C., Rr. "...", nr..., Prishtinë (në cilësinë e kreditorit), për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj përkatësisht autoriteti kompetent i kësaj gjykate - Kryetari i Gjykatës Mustaf Tahiri, *(në tekstin e mëtejme autoriteti kompetent)*, më 27 mars 2023 ka pranuar ankesën e ushtruar nga ankuesi R.B.K. J.S.C. (në cilësinë e kreditorit), kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj F.A., për shkak të shkeljes së vazhdueshme të rregullave dhe parimeve të

paanshmërisë gjyqësore përmes mostrajimit të barabartë të palëve në procedurë dhe mundësimin të përfitimit të personave-debitorëve në formë të kundërligjshme dhe në dëm të kreditorit R.B.

Ankuesi R.B.K. J.S.C., në ankesën e ushtruar ndaj gjyqtarit F.A., ka paraqitur pretendimet se gjyqtari në fjalë diskriminon Institucionin R.B.K. J.S.C. si palë jo e barabart në procedurë në raport me subjektet tjera duke theksuar se vendimet e njëanshme të nxjerra nga ai kanë dëmtuar dhe vazhdon të dëmtohen interesat tyre në cilësi të kreditorit, ndonëse ndaj të njëjtit R.B. ka ushtruar edhe kallzim penal, mirëpo deri më tani nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga ana e institucioneve përgjegjëse dhe kjo nuk është ankesa e pare e paraqitur të njëjtit gjyqtar. Njëherit, ka shtuar se arsyeja për të cilën kanë ushtruar këtë ankesë ndërlidhet me shumë aktvendime të pranuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, për të cilën gjyqtari F.A., në mënyrë jo ligjore ka dëmtuar interesat financiare të R.B. dhe atë përmes lirimit të debitorëve nga detyrimet e papaguara duke mos u mbështetur në argumente faktike dhe juridike. Për më saktë ankuesi në ankesën e tij me shkrim ka shtuar se më datë 2 shkurt 2023 R.B. ka pranuar pesë aktvendime të Gjykatës Themelore në Ferizaj të nxjerra nga gjyqtari F.A., me të cilat është përfunduar procedura përbarimore ndaj debitorëve që kanë marrë kredi në bank, ku në arsyetimin e këtyre aktvendimeve është shënuar pasuesi si vijon ”me shkresën elektronike të datës 29.12.2022, kreditori e ka njoftuar gjykatën se debitori e ka përmbushur obligimin ndaj kreditorit”.

Lidhur me këtë ankuesi ka sqaruar se me datë 21.12.2022 në formë elektronike kemi pranuar kërkesën nga Gjykata Themelore në Ferizaj me të cilën është kërkuar që të verifikohet nëse debitorët kanë kryer obligimet ndaj kreditorit R.B.

Me datë 28.12.2022 R.B. i përgjigjet Gjykatës Themelore, ashtu që ja dërgon në formë të shkruar dhe elektronike të gjitha informatat e kërkuara për debitorët në fjalë duke precizuar nëse të njëjtit janë ose jo në obligime ndaj kreditorit.

Me datë 02.02.2023, Gjykata Themelore në Ferizaj përmes postës elektronike ka dërguar në R.B., aktvendimet me të cilat liron nga detyrimet të gjithë debitorët për të cilët është dhënë informata se të njëjtit kanë detyrime ndaj bankës, pra në kundërshtim me informacionet e dhëna nga R.B. Për

ta sqaruar këtë çështje me datë 03.02.2023 zyrtarët ligjor të R.B., kanë kërkuar nga gjyqtari tërheqjen e këtyre aktvendimeve për të shmangur procedurat e ankesës, mirëpo gjyqtari i ka njoftuar se aktvendimet e lëshuara nuk mundë të tërhiqen me arsyetimin se mundë të ushtrohet ankesë për këtë çështje. Mirëpo gjyqtari në rastet kur pale janë debitorët të cilëve kundërligjshëm ia alte të drejtën, nuk arsyetohej se mundë të ushtrohej ankesë por nxjerrte vendime korigjuese, e si shembull është aktvendimi përmirësues E.nr.569/18 i dates 20.11.2018.

Se gjyqtari është duke vepruar në formë të kundërligjshme ndaj palës R.B., dëshmohej edhe me vendime të tjera siç është aktvendimi CP.nr.35/13 i datës 17 nëntor 2022 i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamentit i Përgjithshëm nxjerrë nga gjyqtari F.A. Duke theksuar se edhe në këtë rast, gjyqtari në fjalë jep konstatim të pavërtet në lidhje me lartësinë e borxhit të debitorit, në atë mënyrë që në vend të konstatoj detyrimin e pashlyer të debitorit në vlerë prej 11.481.56 euro, të njëjtit i`a ngarkon barrën në shumë prej 8.629 euro në emër të borxhit, duke dëmtuar kështu kreditorin R.B., në vlerë prej 2.852 euro, ku edhe në këtë rast kishte vepruar pa ekspert financiar ashtu siç e kërkon plotësim ndryshimi i Ligjit për Procedurën Kontestimore ku giykata duhet Ex officio të caktoj ekspert për fushat në të cilat nuk ka njohuri. Po ashtu ka theksuar se tjetër vendim ku haptazi pamundëson realizimin e borxhit nga kreditori në procedurë përmbarimore është aktvendimi PPP.nr.232/21 ku në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat Sendore, Ligjit për Regjistrimin e Pengut në regjistrin e sendeve të paluajtshme si dhe Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, ia aprovon prapsimin palës kundër urdhërit përmbarimor.

Gjithashtu një vendim tjetër ka të bëj me debitorin F.S., me ç`rast gjyqtra i duke mos caktuar ekspertin përkatës financiar duke i mbledhur vet shumat e kësteve vendos për lartësinë e borxhit.

Po ashtu me aktvendimin PPP.nr.150/16 të dates 01.11.2018, konstatuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.5074/18 ashtu që në kundërshtim me ekypertizën financiare, aprovon vlerë më të ulët të borxhit të mbetur të debitorit ndaj kreditorit R.B..

Andaj, ankuesi kërkon që të shqyrtohet kjo ankesë dhe të vlerësohet më tutje si e bazuar për arsyeje e përmendura dhe kërkon që ndaj të njëjtit të ndërmerret masa disiplinore bazuar në Ligjin për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Për më tepër shih¹.

Gjyqtari i ngarkuar me trajtimin e lëndëve përbarimore F.A. në deklaratën e tij me shkrim lidhur me pretendimet e palës ankuese, ka theksuar se: me lëndët të cilat janë cekur në ankesën e R.B. nuk është i ngarkuar dhe nuk janë të regjistruara në emrin e tij si gjyqtar, por si gjyqtar i lëmisë përbarimore i nënshkruan edhe vendimet, përkatësisht, aktvendimet e nxjerra nga zyra përbarimore e kësaj gjykate. Po ashtu lëndët në fjalë janë të regjistruara në zyrën e përbarimeve dhe me këto lëndë si dhe me lëndë tjera të cilat janë në këtë zyrë procedojnë dhe ndërmarrin veprime procedurale referenti i përbarimeve i kësaj gjykate. Gjithashtu lidhur me pretendimet e kreditorit R.B., në ankesë se: *“Gjyqtari diskriminon institucionin bankar R.B., si palë jo e barabartë në procedurë në raport me subjektet e tjera dhe vendimet e njëanshme të nxjerra nga ana e tij kanë dëmtuar interesat e tyre në cilësi të kreditorit”*, thekson se këtë pretendim e konsideron në tërësi të pa bazuar dhe të pa mbështetur me prova për arsye se në të gjitha lëndët përbarimore me të cilat ngarkohem si gjyqtar, gjithmonë në respektimin strikt të dispozitave të Ligjit të Procedurës së Përbarimit, Ligjit për Procedurën Kontestimore si dhe ligjeve tjera në fuqi. Për më tepër gjyqtari në deklaratë ka shtuar se: gjykata merr si shembull aktvendimet siç janë: E.nr.704/14, e datës 26 maj 2015, PPP.nr 94/16, e datës 3 nëntor 2016, E.nr.247/16, e datës 5 prill 2016, CP.nr.1929/13, e datës 27 dhjetor 2013, PPP.nr.06/16, e datës 18 shkurt 2016, PPP.nr.221/22, e datës 3 prill 2023, të cilat vendime janë nxjerr në pajtim të plotë me dispozitat e LPP-së, e që juridikisht janë në favor të kreditorit R.B.

Tutje gjyqtari theksoi se ekzistojnë edhe shumë vendime tjera të cilat i ka nxjerr gjykata në lëmin përbarimore e të cilat janë në favor të kreditorit por për shkak të numrin të konsiderueshëm gjykata nuk mund t'i përmend të gjitha. Andaj, në rastin konkret, duke i marr për bazë faktet e përmendura nuk bëhet fjalë për ndonjë diskriminimi ndaj kreditorit, sepse si gjyqtar vazhdimisht i trajtojnë palët në të gjitha lëndët përbarimore pa marr parasysh cilësinë apo statusin e tyre në

¹ Ankesë e plotë e ushtruar nga kreditori R.B. dt.27.03.2023.

mënyrë të barabartë duke i shënuar si provë vendimet e mara të evidentuar siç janë përshkruar më lartë.

Po ashtu pretendimi i kreditorit se: *“me datë 2 shkurt 2023 ka pranuar pesë aktvendime të kësaj gjykate të nxjerra nga gjyqtari F.A. me të cilat përfundohet procedura përbarimore ndaj debitorëve që kanë marr kredi në këtë bankë...”*, gjyqtari ka theksuar se konsideron se edhe ky pretendim është në tërësi i pa bazuar, sepse siç është përmendur edhe më lartë me lëndët në fjalë nuk është i ngarkuar si gjyqtar, por këto lëndë janë përfunduar nga referenti i ekzekutimeve të cilat i ka nënshkruar ai si gjyqtar, por që konsiderojmë se në rastin konkret është bërë gabim teknik kur janë përfunduar këto pesë lëndë dhe për më tepër pas diskutimit me referentën e përbarimeve znj. A.B., e njëjta ka njoftuar se pas pranimit të listës me emra të debitorëve lidhur me borxhet e tyre e dërguar përmes emailit me datë 21 dhjetor 2022, ka filluar me nxjerrjen e aktvendimeve për përfundim për shkak të pagesës së borxhit nga debitorët dhe në mesin e lëndëve që i ka përfunduar janë edhe lëndët në fjalë gjithsej pesë lëndë të cilat sipas deklarimeve të referentës së përmendur më lartë në fillim menjëherë pas pranimit të emailit nga kreditori, këto lëndë janë ndarë për të vazhduar me veprime përbarimore me këto lëndë, por që për shkak të numrit të madh të lëndëve me të cilat është e ngarkuar zyra e përbarimeve në këtë gjykatë të njëjtat janë ngatërruar me lëndët të cilat figurojnë në listën e kreditorit të dërguar si lëndë me borxhe të paguara. Po ashtu pas disa ditëve në zyrën e përbarimeve, zyrtarët e kreditorit kanë kërkuar nga gjyqtari anulimin e këtyre pesë aktvendimeve, mirëpo si gjyqtar i ka njoftuar se gjykata nuk mund ta bëjë anulimin në tërësi të aktvendimeve të cilat i ka nxjerrë, përveç nëse është bërë ndonjë gabim teknik në numra, emra apo data dhe të njëjtit i ka udhëzuar që kundër këtyre aktvendimeve kanë të drejtën ligjore të ushtrojnë mjetet juridike, e ku nga shkresat e lëndëve konstatohet se kreditori me datë 10 shkurt 2023, në këtë gjykatë ka dorëzuar ankesat e ushtruara kundër aktvendimeve në fjalë ndërsa gjykata përkatësisht zyra e përbarimeve me zyrtarën A.B., të gjitha lëndët në fjalë bashkë me shkresat e tyre i ka dërguar në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë për vendosje sipas ankesave të kreditorit.

Gjithashtu, sa i përket pretendimeve të kreditorit se: *“Në rastet kur palë janë debitorët të cilëve gjyqtari kundërligjshëm ja fal të drejtën nuk arsyetohet se mund të ushtrohet ankesë por nxjerr*

vendime korrigjuese sa herë paraqitet nevoja siç është përmirësimi i aktvendimit E.nr.569/18”, po ashtu “se ky gjyqtar është duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme ndaj palës R.B., dëshmohet edhe me vendimet e tjera, siç është aktvendimi CP.nr.35/13 i datës 17.11.2022 edhe në këtë rast gjyqtari në fjalë jep konstatim të pa vërtet në lidhje me lartësinë e borxhit të debitorit në atë mënyrë që në vend që të konstatoj detyrimin e pashlyere në vlerë prej 11,481.56 të njëjtit ja ngarkon barrën në shumën prej 8,629 në emër të borxhit”, gjyqtari në deklaratë thekson se edhe këto pretendime i konsideron në tërësi të pa bazuara dhe të paqëndrueshme me arsyetimin se gjykata me rastin e nxjerrjes së aktvendimit E.nr.569/18 të datës 20 nëntor 2018, është bazuar në dispozitat ligjore të nenit 165 paragrafi 1, 2 dhe 4, të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, ku shprehimisht është përcaktuar se: “Gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera me shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit, i korrigjon gjykata në çdo kohë”. Po ashtu në paragrafin 2 të nenit 165 është përcaktuar shprehimisht se: “Korrigjimi i gabimeve bëhet me aktvendim të posaçëm që shkruhet në fund të origjinalit të aktgjykimit, kurse palëve u dërgohet kopja e aktvendimit të tillë”. Për më tepër me nenin 17 të LPP-së është përcaktuar shprehimisht se në procedurën përmbartimore përshtatshmërisht zbatohet dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër. Duke shtuar se gjykata aktvendimin e lartpërmendur e ka nxjerr për shkak të gabimeve teknike që janë bërë në aktvendimin E.nr.569/18, të datës 1 nëntor 2018 dhe duke i marr për bazë faktet e cekura më lartë aktvendimi i cekur nuk mund të krahasohet me aktvendimet të cilat janë nxjerrë nga zyra përmbartimore e kësaj gjykate me të cilat është përfunduar procedura.

Po ashtu sa i përket aktvendimit CP.nr.35/13 të datës 17 nëntor 2022, gjyqtari deklaron se i njëjti është nxjerr në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të nenit 73 paragrafi 1, 2 dhe 3 të LPP-së, ku ky aktvendim sikur edhe aktvendimet tjera përmbajnë këshillën juridike për të cilën nga të dhënat që disponon gjykata kjo lëndë tash më gjendet në Gjykatën e Apelit për vendosje sipas ankesës së ushtruar nga kreditori kundër këtij aktvendimi. Gjithashtu, sa i përket aktvendimit PPP.nr.232/21 të datës 10 shkurt 2023, edhe ky aktvendim është nxjerr në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të nenit 162 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 163 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore dhe nenit 36 paragrafi 1 dhe nenit 73 paragrafi 1,2 dhe 3 të LPP-së edhe ky aktvendim

e përmban këshillën juridike për të drejtën e ushtrimit të ankesës për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.

I njëjti ka shtuar se është me rëndësi të theksohet se bazuar në nenin 107 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila tregon se gjyqtarët në punën e tyre, janë të pavarur dhe vendosin sipas provave dhe fakteve të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe sipas ligjeve në fuqi. Rrjedhimisht gjykata, përkatësisht gjyqtari i çështjes në këtë rast por edhe në të gjitha rastet tjera që ngarkohet më lëndë, ka vendosur në bazë të nenit 17 të LPP-së lidhur me nenin 8.1 të LPK-së, në të cilën shprehimisht është theksuar : *“Se cilat fakte do t’i konsideroj të provuara e cilat jo, vendos vet gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje e të kujdesshme të provave por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit”*. I njëjti rithekson se të gjitha veprimet procedurale të cilat janë ndërmarrë në lëndën E.nr.1922/13, E.nr.1923/13, E.nr.593/11, E.nr.701/14 dhe E.nr.2250/13, janë veprime që janë ndërmarr brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive si gjyqtar, së pari në pajtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenit 107 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-006, për Procedurën Kontestimore, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe Ligjit për Gjykatat në Republikën e Kosovës, si dhe me të gjitha ligjet tjera në fuqi. Për më tepër shih ².

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtarit të rastit si dhe shkresave tjera që janë bashkangjitur nga pala ankuese por edhe shkresave tjera të këtyre lëndëve, ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga gjyqtari F.A.

Autoriteti kompetent ka vërtetuar faktin se gjyqtari në lëndët E.nr.1922/13, E.nr.1923/13, E.nr.593/11, E.nr.701/14 dhe E.nr.2250/13 me datë 29.12.2022 ka nxjerrë aktvendimet me të cilat është përfunduar procedura përmbarimore sipas detyrës zyrtare, me arsyetimin se kreditori e ka njoftuar gjykatën se debitori ka përmbushur obligimin ndaj kreditorëve dhe kjo është vërtetuar edhe nga vetë deklaratat e gjyqtarit F.A.

² Deklarata e gjyqtarit F.A., dt. 04.04.2023

Autoriteti kompetent me një kujdes të veçantë ka analizuar pretendimin e ankuesit se gjyqtari në mënyrë të vazhdueshme ka shkelur rregullat dhe parimet e paanshmërisë përmes mostrajtit të barabartë të palëve në procedurë dhe mundësimin të përfitimit të personave në formë të kundërligjshme në dëm të kreditorit, mirëpo në rastin konkret ka vlerësuar se këto pretendime nuk janë të bazuara. Për më tepër në kronologjinë e procedimit të këtyre pesë lëndëve, fillimisht kemi një komunikim përmes formës elektronike në mes të zyrtares-referentes për ekzekutime të Gjykatës Themelore në Ferizaj me zyrën ligjore të R.B., e kjo vërtetohet përmes e-mailit të datës 21.12.2022 ku e njëjta i është drejtuar kësaj zyre me kërkesën që të verifikohen nëse debitorët kanë kryer obligimet ndaj kreditorit R.B., duke ia bashkangjitur edhe propozimet për përmbarim për debitorët për të cilët ka kërkuar informacione. Në përgjigjen e zyrtarëve ligjor të R.B., përmes e-mailit zyrtar të datës 28.12.2022 është njoftuar referentja e ekzekutimeve lidhur me kërkesën e sajë gjegjësisht kreditori ka dërguar një listë me informacionet lidhur me debitorët të cilët i kanë përmbushur obligimet dhe ata të cilët ende nuk i kanë përmbushur obligimet ndaj kreditorit në këtë rast R.B.

Përmes shënimit zyrtar i datës 31.03.2023 të deponuar nga referentja e zyrës së përmbarimeve, vërtetohet se e njëjta pas pranimit të kësaj përgjigjeje nga ana e kreditorit, i ka ndërmarrë veprimet procedurale për ti përfunduar lëndës të cilat debitorët i kanë përmbushur detyrimet, në mesin e këtyre lëndëve janë veçuar pesë lëndët përmbarimore dhe atë E.nr.1922/13, E.nr.1923/13, E.nr.593/11, E.nr.701/14 dhe E.nr.2250/13 për të cilat kreditori ka njoftuar se debitorët nuk i kanë përmbushur në tërësi detyrimet, mirëpo për shkak të stërngarkesës me numër të madh të lëndëve që janë në zyrën e përmbarimeve, këto lëndë bashkë me lëndët tjera gabimisht zyrtarja i ka përfunduar si të kryera duke nxjerrë aktvendime dhe duke përfunduar procedurën përmbarimore. Pra duke pas parasysh që i gjithë komunikimi në raport me këto lëndë, pra që nga dërgimi i e-mailit zyrtar, përmes të cilit janë kërkuar informacione nga kreditori lidhur me debitorët që i kanë përmbushur apo jo obligimet, përgjigja e kthyer nga kreditori ka qenë në mes referentes së ekzekutimeve dhe zyrtarëve të R.B., ka qenë nga referentja e zyrës së përmbarimeve me zyrtarët e R.B., përfshirë këtu edhe përgatitjen nga ana e zyrtares e këtyre pesë aktvendimeve me të cilën është përfunduar procedura përmbarimore dhe se gjyqtari i ka nënshkruar këto aktvendime të cilat zyrtarja për shkak të këtij gabimi dhe ngatërimit të tyre duke menduar se janë në listën e

debitorëve të cilët kanë përmbushur obligimet ndaj kreditorit edhe janë nënshkruar nga ana e gjyqtarit. Andaj nuk mundë të themi se ka qenë një shkelje që do të justifikonte inicimin e procedurës disiplinore për gjyqtar, duke pasur parasysh e aspektin objektiv siç është ngarkesa e madhe me lëndë që ka zyra e përmbarimeve, stafin që i trajton këto lëndë, dhe se vetëm një zyrtare merret me trajtimin e këtyre lëndëve, volumin e madh të punëve gjatë periudhës së fund vitit kohë kur edhe ka ndodhur ky rast, janë faktorë që kanë ndikuar të vije deri tek ky gabim nga ana e referentes, e cila i ka ngatërruar lëndët të cilat nuk i kanë plotësuar kushtet për tu konsideruar si të përfunduara, me ato që kanë qenë të përfunduara, por nuk mund të themi se pretendimi i ankuesit se kemi shkelje të vazhdueshme të rregullave dhe parimeve të paanshmërisë dhe mos trajtim të barabartë të palëve në procedurë, ngase të pesë këto Aktvendime janë përgatitur nga ana e referentes në të njëjtën ditë pra me datë 29.12.2022 dhe të njëjtën ditë janë nënshkruar nga ana e gjyqtarit.

Për më tepër edhe Gjyqtari por edhe zyrtarja përmbaruese kanë udhëzuar palën kreditore që për këto Aktvendime E.nr.1922/13, E.nr.1923/13, E.nr.593/11, E.nr.701/14 dhe E.nr.2250/13, të shfrytëzohet mjete juridik, ankesa në gjykatën e shkallës së dytë, dhe ashtu edhe është vepruar dhe këto lëndë sipas zyrës përmbarimore janë dërguar në Gjykatën e Apelit për të vendosur në lidhje me ankesën e parashtruar nga kreditori.

Po ashtu sa i përket pretendimeve të ankuesit, lidhur me Aktvendimet CP.nr.35/13 të datës 17.11.2022, PPP.nr.232/21 dhe PPP.nr.150/16 të datës 02.11.2018, ku gjyqtari ka vepruar kundërligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, në lidhje me caktimin e lartësisë së borxheve pa caktuar ekspert ashtu siç përcaktohet me ligj, apo në kundërshtim me ekspertizat financiare ashtu siç janë përcaktuar, Autoriteti kompetent i kësaj gjykate vë në pah se nuk ka të drejtën e komentimit të vendimeve të marra nga gjykata përkatësisht nga gjyqtari, sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdoqoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi. Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për

veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”. Gjithashtu, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate konsideron se, për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarëve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta nga pala e pakënaqur por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, si dhe bazuar në të dhënat e përshkruara si më lartë Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillim të hetimeve disiplinore.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

ADGJTHFR.nr.5/23

25 prill 2023

Mustaf TAHIRI

Kryetar i Gjykatës

Iu dërgohet:

R.B.K. J.S.C., Rr. “...” nr. ..., Prishtinë – Kreditori - Parashtrues i ankesës

F.A. - Gjyqtar

Këshillit Gjyqësor të Kosovës